



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Furnizim me serra

Ftohen të gjithë fermerët e komunës së Prishtinës të aplikojnë për furnizim me serra-tipi "Tunel", në sipërfaqe prej 0.05 ha.

Kriteret e përgjithshme:

- Aplikuesi duhet të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor rezident i saj;
- Fermerët të cilët planifikojnë ngritjen e serrës 0.05 ha, duhet të posedojnë sipërfaqe prej së paku 0.07 ha në hapësirën e planifikuar për ngritjen e serrës;
- Parcela për ndërtimin e serrës duhet të jetë e gjatë së paku 67 m dhe e gjerë së paku 13 m;
- Nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtar i bashkësisë familjare;
- Fermerët të cilët nuk kanë pronën në pronësi familjare, por shfrytëzojnë toka më qira, duhet të kenë marrëveshje të nënshkruar nga palët, të noterizuar, në kohëzgjatje për dhjetë (10) vjet;
- Fermerët duhet të posedojnë së paku një sipërfaqe prej 0.10 ha, të mbjellë me perime në sipërfaqe të pandarë;
- Fermerët dhe anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare të cilët kanë përfituar serrë nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën në tri (3) vjetët e fundit, nuk kanë të drejtë përfitimi;
- Përfituesit nuk kanë të drejtë t'i shesin apo të tjetërsojnë serrat gjatë pesë (5) vjetëve pasuese;
- Përgjegjësitë në mes përfituesit dhe Komunës së Prishtinës, do të përcaktohen përmes kontratës së nënshkruar në mes palëve.

Kriteret specifike:

- Në kushte të barabarta, përparësi kanë zonat me prioritet të identifikuar nga Komuna;
- Fermerët me sipërfaqe më të madhe, kanë përparësi në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të mbjellë me perime (spec, domate, sallatë të gjelbër, tranguj , karota, qepë, hudhër) ;
- Njohuri elementare në fushën përkatëse;
- Fermerët me përgatitje profesionale shkollore (shkolla e mesme bujqësore, fakulteti përkatës);
- Fermerët të cilët kanë ndjekur trajnime përkatëse;
- Gratë fermere dhe grupet e marginalizuara;
- Prona në pronësi të aplikuesit (fermerit);
- Prona e marrë me qira;
- Infrastruktura përcjellëse (burimi i ujit, sistemi i ujitjes);
- Largësia e fermës nga vendbanimi;
- Konfiguracioni i terrenit;
- Përparësi do të kenë fermerët të cilët posedojnë parcela me bonitet më të lartë të tokës (sipas klasifikimit të tokës-fleta poseduese).

Dokumentacioni:

- Numri identifikues i fermerit (NIF);
- Kopja e një dokumenti identifikues valid të Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, jo më e vjetër se një vit;
- Kopja e planit, jo më e vjetër se një vit;
- Kontrata e shfrytëzimit të tokës;
- Vërtetimi i tatimit në pronë për vitin 2022.

VËREJTJE

Nëse komisioni parasheh të nevojshme sjelljen e dokumenteve shtesë, të cilat mundësojnë zgjedhjen e përfituesit, aplikuesi (fermeri) është i obliguar t'i sjellë ato në afatin e caktuar, në të kundërtën, e humb të drejtën për të qenë përfituesi i subvencionit (grantit).

Data e aplikimit, nga 14.06.2023 deri më 30.06.2023.